

VENDIM
Nr. 54, datë 3.3.2025

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “GREEN ENERGY TRADING ALBANIA”
SHPK PËR HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, germa “dh”, 7, paragrafët 2 dhe 9, germa “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 5.1, germa “dh”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 260/4 prot., datë 28.2.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Green Energy Trading Albania’ sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., e licencuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 59, datë 23.4.2015, të Bordit të ERE-s, dhe me licencë të rinovuar për një afat 5-vjeçar, me vendimin nr. 72, datë 22.4.2020 (deri më 24.4.2025), ka njoftuar ERE-n se nuk do të kërkojë rinovimin e licencës. Shoqëria ka vendosur të nisë procedurat e likuidimit dhe, për këtë arsye, ka kërkuar udhëzimet përkatëse.

- Pas shkëmbimit të korrespondencës me shoqërinë, lidhur me detyrimet e saj dhe duke qenë se ajo është në fazën përfundimtare të likuidimit, si dhe bazuar në rakordimin e kryer, rezulton se aktualisht nuk ka detyrime ndaj ERE-s për pagesat e mëparshme të rregullimit. Në kushtet kur pagesat e rregullimit për vitin 2025 ende nuk janë përcaktuar, vlerësohet e arsyeshme miratimi i kërkesës së saj për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenin 5, germa “dh”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe në pikën 5.1, germa “dh”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, përcaktohet se: ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.

- Në nenin 7, paragrafi 2 i rregullores së sipërcituar, përcaktohet se: “Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, germa “d” të kësaj rregulloreje parashikohet se: “... Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.”.

- Duke qenë se ndodhemi në kushtet kur kërkesa për heqjen e licencës vjen nga vetë i licencuari, vlerësohet të procedohet menjëherë me miratimin e kësaj kërkeje dhe heqjen e licencës.

- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. e humbet fuqinë juridike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 286, seria T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 23.4.2015 dhe rinovuar me vendimin nr. 72, datë 22.4.2020.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti